



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:080300

Datë: 15.07.2019

Numri i dokumentit: 00409160

**P.nr.87/2019**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC/**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me sekretaren juridike Shemsije Shehu, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. I. nga Rahoveci, rr." M. I.", për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378/8-6-1 nga neni 314/6-1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1777/2018 të datës 14.03.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurori i Shtetit Mone Syla, të akuzuarit, më datë 09.07.2019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **I akuzuari,**

**M. I.**, nga i ati J. dhe e ëma Q., e gjinisë D., i lindur më dt. ..., në Rahovec, ku edhe tani jeton, rr. "M. I.", p.n., ka të kryer fakultetin ekonomik, punëtorë, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

## **Ë S H T Ë F A J T O R**

### **Sepse:**

Me dt.22.10.2018, rreth orës 17:30h, në Rahovec, në aksin rrugor Gexhë-Ratkoc, pikërisht në fsh.Radostë, Komuna e Rahovecit, duke drejtuar automjetin e tij të markës "VW LT35", me targa regj. ...-...-AD, ngjyrë e bardhë, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 53 lidhur me neni 255 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor nr.05/L-088, dhe vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, nga pakujdesia, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se me një veprim të tillë do të vijë deri te pasoja do t'i shmanget, dhe pasoja është shkaktuar, në atë mënyrë që me të arritur në fsh.R., duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, nuk e vëren këmbësorin e mitur A.K, dhe pjesën e përparme të krahut të majtë e godet dhe e hedh në asfalt, i cili në momentin kritik kishte filluar kalimin e rrugës nga ana e majtë në të djathtë të drejtimit të automjetit, me ç'rast i shkakton të dëmtuarit/fëmijën A.K i shkakton lëndime të rënda

trupore, lëndime të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të dr.Flamur Dyllhasi, e dt.23.02.2019.

-Këso dore ka kryer vepër penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378/8-6 lidhur të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 7,41, 46, 73, 378/8-6-1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton:

## **DËNIMIN ME BURG**

**Me burgim në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjet (180) ditëve.**

**Gjykata me pëlqimin e të dënuarit, në kuptim të nenit 47 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjet (180) ditëve ditëve, ia zëvendëson me dënim me gjobë në shumën prej pesëqindë (500) euro, e cila gjobë duhet të paguhet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

Po që se i akuzuari dënimi me gjobë në shumën prej pesëqind (500) euro, nuk e paguan mbrenda afatit të caktuar, në kuptim të nenit 46 të KPRK-së, dënimi me gjobë, do të revokohet me dënim me burgimi, në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjet (180) ditëve.

I dëmtuari A. (J.) K., nga fshati R., Komuna e Rahovecit, udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest të rregulltë civil.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej 20,00 euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën prej 40,88 euro, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 30,00 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka parashtuar aktakuzën, PP/II.nr.1777/2018 të datës 14.03.2019, kundër të akzuarit M. I., nga Rahoveci, rr."M. I.", p.nr., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378/8-6-1 të KPRK-së,

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 08.07.2018, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Mone Syla dhe i akuzuari M. I., ndërsa nuk ka qenë prezentë i dëmtuari për të cilën gjykata nuk ka provë se është ftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i cili ka qëndruar në tërësi pranë saj. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, si dhe e ka njoftuar lidhur me efektet e pranimit të fajësisë. I akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se ndihet fajtor dhe ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur. Njëherit deklaroi se se me familjen e të dëmtuarit i ka raportet shumë të mira dhe në vazhdimësi kanë qenë të kujdesshëm ndaj fëmiut.

Pasi i akuzuari e ka pranuar fajësinë, po ashtu është kërkuar edhe mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare pa kurrëfarë presioni si dhe aktakuza gjen mbështjetjen në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Andaj nga të lartcekurat, pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 248 par. 4 të KPPK-së, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës fillestare është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata nuk ka proceduar administrimin e provave.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378/8-6-1 të KPRK-së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat të cilat i përmbante aktakuza e të cilat janë:- Raporti policor mbi vend shiqimin e aksidentit të përpiluar nga zyrtari policor Sh. Z.;

- Skica e vendit të ngjarjes;
- Ekspertiza e komunikacionit;
- Ekspertiza mjeko-ligjore;
- Deklarata e të pandehurit, dhënë në PTH në Gjakovë, si dhe shkresat tjera në lëndë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 73 dhe 74 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit i ka shqiptuar dënimin me kusht, me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale dhe paushallit gjyqësor bazohet në nenin 450 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.1 dhe 2.6, lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr.87/2019, më datë 09.07.2019**

**Sekr. juridike,**  
**Shemsije Shehu**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Mizahir Shabani**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimet nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë.